



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 281/1 prot.

Tiranë, më 09.06.2026

SHPLLJE PUBLIKE

(Për efekt njoftimi ndaj subjektit z. Rogert Sterkaj)

Në bazë të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenit 147 dhe vijues të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizon këtë shpallje publike për njoftimin e:

Z. Rogert Sterkaj, në cilësinë e subjektit kundër së cilit drejtohet ankesa nr. 38, datë 05.02.2026, e paraqitur nga Fondacioni Së Bashku kundër Top Channel, Big Brother Albania Vip, z. Rogert Sterkaj, pjesmarrës në programin Big Brother Albania Vip, në Televizionin Kombëtar Top Channel, me pretendimin për diskriminim/ gjuhë urrejtje, për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Ky njoftim kryhet në kushtet kur, Komisioneri nuk disponon një adresë postare të z. Rogert Sterkaj, për njoftimin e tij në mënyrë individuale në kuadër të shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur.

Me anë të kësaj shpallje, konsiderohet se z.Rogert Sterkaj njoftohet për:

1. Shkresën nr. 281/1, datë 18.02.2026 “Njoftim dhe kërkesë për informacion”, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Shkresën nr. 281/3 prot., datë 17.03.2026 “Kërkesë e përsëritur për parashtrime”, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
3. Vendimin nr. 136, datë 28.05.2026, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Kjo shpallje publikohet në :

- Ambientet e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Faqen zyrtare në internet të institucionit: www.kmd.al

Personi i njoftuar me shpallje publike mund të paraqitet pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të marrë informacion më të plotë apo për të deklaruar të dhënat e tij të kontaktit apo përfaqësuesit ligjor.

Ky njoftim qëndron i afishuar për jo më pak se 10 ditë.

Me kalimin e 10 ditëve nga afishimi subjekti konsiderohet i njoftuar dhe procedura administrative ndaj tij mund të vijojë në mungesë.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

